

<p style="text-align: center;">DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</p>	<p style="text-align: center;">SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</p>	<p style="text-align: center;">POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU</p>
--	---	--

ASC -09-0108

Në kontestin e

1. [REDACTED], nga fshati Sushicë

Paditësit

Komuna e Prishtinës

2. [REDACTED], nga fshati Uglar

Komuna e Fushë Kosovës

3. [REDACTED], nga fshati Gushterica e Epërme
të gjithë të përfaqësuar [REDACTED], Avokat nga Prishtina
Rruga "[REDACTED].

Vs

[REDACTED] *E Paditura/Ankuese*
E përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e privatizimit

Paneli i Ankesave i Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, sipas ankesës së të Paditurës kundër vendimit të DHPGJS-së, SCC-08-0217 të datës 24 nëntor 2009, pas seancës së vendimmarrjes të mbajtur me 8 mars 2010 lëshon këtë:

AKTVENDIM

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në rast ankimi, pikët 1 dhe 4 të vendimit të DHPGJS-së, SCC-08-0217 të datës 24 nëntor 2009, eliminohen.

Arsyet Ligjore:

Në padinë e tyre të datës 10 maj 2007 ushtruar në Gjykatën Komunale të Prishtinës me numrin C nr 1196/07, Paditësit kërkojnë anulimin e kontratës për shitblerje të ngastrave të caktuara tokësore e lidhur në mes të atit të tyre [REDACTED] dhe të Paditurës.

Me 2 janar 2008, Gjykata Komunale e Prishtinës e ka hedhur poshtë padinë mbi bazën se (vetëm) DHPGJS-ja është kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Me 11 korrik 2008, Paditësit kanë ushtruar padi në DHPGJS për të njëjtën çështje, duke kërkuar anulimin e kontratës për shitblerje (në mesin e arsyeve tjera të dhëna) për lidhje të saj nën kërcënim, dhe obligimin e së Paditurës që t'ia kthejë pronësinë dhe posedimin Paditësit për token e kontestuar.

Gjatë procedurës së mëtejme, Paditësit kanë paraqitur kërkesë për "delegimin" e lëndës në Gjykatën Komunale të Prishtinës, "për ta vazhduar procedurën".

Pas VE të UNMIK-ut 2008/34, me datë 10 shtator 2008 DHPGJS-ja e ka pezulluar procedurën.

Me aktgjykimin e kontestuar të datës 24 nëntor 2009, DHPGJS-ja e ka hequr tërësisht pezullimin, e ka ftuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) në gjykim (1) e ka dërguar lëndën në Gjykatën Komunale të Prishtinës (2) ka cekur se ankesa ndaj çdo vendimi të Gjykatës Komunale të Prishtinës do të bie në përgjegjësi të DHPGJS-së (3), dhe ka konsideruar se ankesat ndaj këtij vendimi duhet dërguar në Panelin e Ankesave të DHPGJS-së (4). Në arsyetimin ligjor, trupi gjykues thekson se ishte e "domosdoshme që të ushtrohej juridiksion mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit në mënyrë që padia të gjykohej plotësisht", andaj ata edhe ftohen në gjykim, thekson se Gjykata Komunale në Prishtinë si gjykatë tek e cila lënda është referuar do të duhej që jetë veçanërisht kompetente për ta vendosur çështjen në mënyrë të paanshme dhe në harmoni me dispozitat relevante të Nenit 4.2 të RREG së UNMIK-ut 2008/4 dhe nenit 15 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, konsideron se sipas "Nenit 70.3 (a) të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2008/6, dhe Neneve 206 dhe 207 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, asnjë ankesë e veçantë nuk lejohet kundër vendimit për ta ftuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit në gjykim" dhe përsëritë përmbajtjet e pikave (3) dhe (4) të dispozitivit.

Në ankesën e ushtruar me kohë nga AKP-ja në emër të së Paditurës, nga Paneli i Ankesave të DHPGJS-së kërkohej që të "ndryshohet vendimi".

Ankesa duhet të refuzohet si e pa bazë.

Para se të merremi me përmbajtjen e ankesës, duhet bërë një vërejtje paraprake lidhur me përfaqësimin e Ndërmarrjes Shoqërore (NSH) nga AKP-ja si palë në DHPGJS-së.

III

AKM, e themeluar në nëntor 2002 me RREG e UNMIK-ut 2002/13, të ndryshuar me RREG e UNMIK-ut 2005/18, ka pushuar së funksionuari në Qershor 2008. Aktivitetet e saj, duke përfshirë edhe përfaqësimin e Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH-të) para DHPGJS-së, pastaj faktikisht u morën nga AKP.

Duke pasur parasysh gjendjen faktike aktuale në Kosovë se AKM nuk i ushtron më detyrat dhe kompetencat e saj siç definohet në RREG e UNMIK-ut 2002/13, me ndryshime, pastaj, duke pasur parasysh se ekziston nevoja urgjente që NSH-të të përfaqësohen para DHPGJS-së dhe duke konsideruar si rregull themelore se sistemet ligjore që zbatojnë fuqinë e ligjit nuk lejojnë vakum ligjor, përfaqësimi i NSH-ve nga AKP për momentin pranohet.

Në këtë ankesë, AKP nuk vepron në emër të saj (që ftohet në gjykim si e Paditura (2) por (vetëm) në emër të përfaqësueses (1). Siç përmendet më lart, ky përfaqësim i së Paditurës nga AKP konsiderohet si i drejtë.

Vendimi i atakuar fare nuk e përmend meritën e çështjes. Pa iu referuar arsytimit ligjor të dhënë këtu, prapë se prapë, Ankuesi flet vetëm për meritën e çështjes dhe thekson se vendimi ka qenë i konfuz dhe i paqartë rreth fakteve relevante, lidhur me objektin e lëndës që duhet ti nënshtrohet shqyrtim-votimit.." dhe se ai nuk "përbante prova të sakta te ngastrave kadastrale, sipërfaqen e ngastrave dhe vendin e tyre". Në veçanti, ankesa nuk tregon ndonjë arsye se pse Ankuesi mund të jetë i mendimit se pika 2 (vendimi i referuar) është e pasaktë.

Në këto rrethana, pika 2 (vendimi i referuar) duhet të vërtetohet. Nuk mund të shihen pengesa për Gjykatën Komunale që ajo të merr një vendim të drejtë siç parashihet me Nenin 15.1 (b) të UA-së 2008/6. Përveç kësaj, Gjykata Komunal veç kishte filluar të mbledh prova mbi meritën e lëndës para se të merrej vendimi mbi kompetencën e saj. Referimi i lëndës dhe 'vazhdimi' i saj në Gjykatën Komunale mundet në mënyrë spontane ta shpejtojë procedurën.

E njëjta gjë vlen edhe për piken 3: nuk shihen arsye se pse vendimi për drejtimin e ankesave të mundshme kundër vendimit të Gjykatës Komunale në DHPGJS (shih Nenin 4.3 të RREG 2008/4) nuk është korrekt. Edhe ankesa nuk jep ndonjë arsye. Si rrjedhojë, edhe pika 3 duhet të vërtetohet, gjithashtu.

Sa i përket pikës 1 të vendimit të ankimuar: nuk mund të gjendet ndonjë arsye e vlefshme se pse ka qenë apo do të ishte "e nevojshme që të ushtrohet juridiksion mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit në mënyrë që padia plotësisht të gjykohej", dhe që ata të ftohen në gjykim, siç e ka bërë edhe Trupi Gjykyes. Për më tepër, nuk ka indikacione se AKP-ja duhet të ketë ndonjë interes (të vetin) për lëndën në fjalë. Ata mund vetëm të veprojnë në emër të (të vetmes) palë që është paditur, gjë që ata faktikisht po e bëjnë. Ky është i vetmi rol që ata mund ta luajnë në këtë kontest. Andaj me rastin e ndonjë ankimi pika 1 e vendimit duhet hequr.

IV

Gjithashtu duhet të vërehet se informacioni shtesë i dhënë nga trupi gjykyes rreth përjashtimit të ndonjë ankimi kundër pikës 1 të vendimit nuk është korrekt; sipas Nenit 9.5 të RREG 3008/4, në parim të gjitha vendimet e trupit gjykyes mund të ankimohen; kjo dispozitë shërben si një *lex specialis* për dispozitat e cituara në vendimin e ankimuar (Neni 206,207 i Ligjit të Procedurës Civile, Gazeta Zyrtare 4/77-1478 etj e RSFJ-së) edhe nëse ato duhet konsideruar si të zbatueshme këtu. Veç kësaj, Neni 207 leg cit, fjalia e fundit, do të përjashtonte vetëm ankesat "e veçuara" gjatë procedurës, po jo edhe ankesat kundër vendimit të formës së prerë. Së fundi, Apeli i Ankesave e ka kompetencën e plotë mbi vendimin për pranueshmërinë e ankesave

Së fundi, pika 4 e vendimit të ankimuar poashtu duhet të hiqet me rastin e ankimit sepse udhëzimet për ushtrim të ankesës duke cituar ligjin, pa ndonjë liri veprimi nga ana e gjykatës nuk janë vendime që duhet të merren në diapozitiv. Informacioni i tillë mund të epet në arsyetimin ligjor apo- më mirë- vetëm ti bashkëngjitet vendimit, por nuk mund të jetë pjesë e tij.

Vërejtjet e Ankuesve sa i përket çështjes së suksesionit ligjor të Paditësve nga pronari i ndjerë i pronës në fjalë, mund të trajtohet si çështje e vlefshme, por mund të ngritet nga Gjykata Komunale e Prishtinës kur të shqyrtohet merita e lëndës.

E njëjta gjë vlen për çështjen e njoftimit të saktë të Agjencisë lidhur me qëllimin për të ushtruar padi.

Siç njoftohet më vonë, autorizimi për përfaqësimin e Paditësve nuk është gjetur, së paku jo në dosjet e lëndës të DHPGJS-së. Edhe këtij fakti mund ti kushtohet vëmendje.

Eventualisht, Gjykata Komunale e Prishtinës mund ta sheh nevojën ta qartëson identitetin e Ankuesit; sipas informacionit që ka DHPGJS-ja, "[REDACTED]" si ndërmarrje e bashkuar mund të mos ekzistojë më sikur në formën e mëparshme.

Vendimi mbi shpenzimet nuk duhej të merrej.

Richard Winkelhorf, Gjyqtar Kryesues, EULEX	(nënshkrimi)
Torsten Koschinka, Gjyqtar, EULEX	(nënshkrimi)
Elija-Liisa Helin, Gjyqtare, EULEX	(nënshkrimi)
Tobias Lapke, Regjistruer, EULEX	(nënshkrimi)